



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14428 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK
NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

Datë 09.09.2024 ora: 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetari i Nj.A. Orikum, z.Selim Haskocelaj, Drejtori i Financës – z. Kozma Mali, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media,

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur për të prezantuar projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Vlorë 2025-2027 si dhe buxhetin e vitit 2025.

Disa nga investimet e parashikuara. Është punuar dhe kryesisht;

-Në fshatin Tragjas, rikonstruksioni i rrugëve;

-151 ndriçues, ndërkohë që do shoqërohen me rrugën, me vlerë 500 milion lekë/vjetra, thjesht është në tenderim. Pra, si premtim që nga viti i kaluar, çfarë kemi thënë, dhe çfarë kemi bërë.

-Edhe Rruga e Radhimës , është në proces tenderimi, është afati 1 javë për ankimim, në qoftë se nuk ka, do vazhdojnë punimet. Brenda vitit mbaron 3 km.

Banor: Është segment i shkurtër rruge. Rruga Radhimë nga lart, çfarë bëhet?

Z.Ermal Dredha – Sa është ...si kohëzgjatje kjo rrugë , pra 3 muaj që nga fillimi. Rruga e Orikumit, po presim dhe shtyllat me ndriçues dhe ta inagurojmë.

-Shkolla “Hasan Pulo “. Është e njëjta situatë , është në tenderim dhe presim të fillojmë punimet.

-Shëtitorja e Tragjasit – 35 milion lekë/vjetra. Para datës 15 tetor, mbyllet procedura e tenderimit. Projekti për një javë është gati.

-Rruga e Tragjasit, planifikuar 50 milion lekë/rinj.

-Rikonstruksioni i shëtitorës në fazën e projektit nga drejtoria.

-Rikonstruksioni i fasadave të pallateve përgjatë bulevardit, presim përgjigje nga FSHZH.

-Kam bërë një takim në Dukat fshat, gjatë fushatës elektorale, rruga ishte shumë e keqe. Premtova që do ta rregullonim dhe kemi lobuar me FSHZH, do ta bëjmë. Bëra një sqarim për ato që kisha premtuar.

Z.Lefter Leka/Banor – Edhe vitin e kaluar jemi mbledhur. Kam problemin tim, jemi gjashtë familje.

Z.Selim Haskoçelaj - Është një rrugë rreth 8 milion lekë/vjetra, po pritet të bëhet.

Z.Lefter Leka – Nuk është bërë deri tani. Administrata e ka parë. Unë kam bërë pjesën që më takon. Rrezikohemi në familjet, rruga është shumë e keqe. Të planifikohet një buxhet minimal.

Z.Ermal Dredha– Do vijnë inxhinierët ta shohin, patjetër. Do bëhet dhe Lungomarja e Orikumit. Është projekt i qeverisë, do ti rritet vlera pronës.

Z.Arsen Belaj /Anëtar i KB - Po flas si banor, jo si këshilltar. Kryetar, në Orikum nuk është bërë asnjë investim.

Z.Ermal Dredha -- Kemi shumë projekte për të bërë.

Z.Arsen Belaj – Ishin dy projekt, shkolla dhe Rruga e Radhimës. Infrastruktura shumë e keqe, ndriçimi mungon. Thoni çfarë investimi është bërë në Orikum, Radhimë, Dukat...Plehrat shumë keq. Deri tani, nuk është bërë asgjë.

Z.Ermal Dredha – Lobimi është bërë, është në këtë projektbuxhet i planifikuar.

Z.Gëzim Çapoj/Anëtar i KB – E kemi diskutuar dhe me kryetarin.

Z.Arsen Belaj -- Zoti Kryetar! Ktheni sytë nga Orikumi, jemi zonë turistike.

Z.Hamza Kuteli / Banor – Kam qenë anëtar i këshillit të bashkisë.

Z.Gëzim Çapoj – Kemi probleme, nuk është të bësh politikë.

Z.Mehmet Xhelilaj – Çfarë është menduar për lagjen e “Xhenjos”...Jemi disa familje. Janë rreth 500 m pa ndriçim, vetëm tre llampa duhen. Problem rruga dhe ujrat e zeza. Tek pallati i “Xhenjos” daljet janë nga mbrapa. Janë nëntë familje në pallat. Edhe uji i pijshëm, problem.

Z.Selim Haskoçelaj – S’kanë kuota.

Z.Mehmet Xhelilaj – Po.

Z.Aulon Veizi /Sh.A.Ujësjiellës, presim të bëjmë investimin e ri.

Z.Arsen Belaj – Shumë keq me ndriçimin, tre llampa në rrugën kryesore.

Z.Zambak Selmani -- Do riasfaltohen rrugët ...do bëhet dhe ndriçimi.

Z.Myzafer Elezi /Anëtar i KB – Zoti Kryetar!

Vitin e kaluar bëra disa propozime në lidhje dhe me rrugën në fshatin Dukat. Nuk është ezauruar. Rruga është e amortizuar, banojnë rreth 60 familje. Të përfshihet, të jetë në prioritetet e këtij buxheti.

Z.Hamza Kuteli – Kemi bërë ankesë për investimin e ujrave të zeza. Kush është përgjegjës.

Z.Ermal Dredha – Drejtoria e Infrastrukturës. Bëhet kërkesë në bashki dhe ia dërgojmë Ujësjiellësit.

Z.Mezin Ramohitaj -- Autobuzat e linjës së Tragjasit, duhet të futen në qendër , në Orikum, por si lejojnë ata të Orikumit. Të shihet linja.

Z.Arsen Belaj -- Linja është e Tragjasit, nuk e lënë ata të Orikumit.

Z.Ermal Dredha – Duhet të kalojë në këshill bashkie.

Banor: Veshja e pallateve me kapotë. Nuk janë veshur të gjithë pallatet, kanë ngelur ca pa bërë.

Z.Selim Haskoçelaj – Është projekt, do mbarojnë dhe ato pallate.

Z. Foto Gjipali -- U diskutua për shkollën “Hasan Pulo “, them për shkollën “Hasan Mëhilli “, në fshatin Dukat. - Në Dukat të Ri, uji është 24 orë. Kemi nevojë për një shtrim tubi, rreth 1300 m. Një depozitë duhet.

Znj.Flora Meçe/ Banore -- Meqenëse thatë që do bëhet Lungomare deri ku?

Z.Ermal Dredha --Është projekt i FSHZH, do dalë dhe VKM për shpronësim.

Znj.Flora Meçe- tek ne është një zonë e tërë. -Problem ujrat e zeza, ato nga Radhima, zbresin në rrugë.

Z.Aulon Veizi – Është bërë një impiant që shumë shpejt do të vihet në punë. Kemi patur probleme , por i kemi zgjidhur.

Znj.Flora Meçe – Jemi me gropa septike.

Z.Gjergji Nika /Anëtar i KB -- Dy sygjerime do të bëja. FSHZH implementon dhe informacionin e jep bashkia. Për Lungomaren në Orikum, dy sygjerime. Përveç atyre që kanë pikat e shërbimit në pronat e tyre, a ka mundësi që edhe ata që kanë pika shërbimi, por pa hiptekuar, por që kanë shumë vjet që punojnë...Të gjendet një mënyrë, përveç atyre që janë në tokën e tyre.

Z.Ermal Dredha – Idea është për rastet specifike. Propozimet vijnë nga subjektet.

Z.Gjergji Nika – A ka mundësi t’ju vejë bashkia, të bëhet dhe një dëgjese tek qytetarët?

Z.Gëzim Çapoj/Anëtar i KB -- Duke qenë se diskutojmë ProjektBuxhetin për vitin 2025, ne ngremë problemet tona. Ka vite në Orikum që nuk bëhen gjëra të rëndësishme. Qendra është Orikumi, pra të kemi qytet të pastër, të bukur. të rregullojmë shkollat, fëmijët po shkojnë në shkojnë në Vlorë. Duhet dhe një diskutim me Drejtorinë Arsimore. Sa më shpejt të bëjmë disa gjëra. Kemi shumë kohë që po punojmë për Vlorën. Ky vit që vjen, të jetë i Orikumit. Kemi problemet por dhe gabimet tona.

Duhet të vijë momenti të shikohet Orikumi, të rregullohet cilësia e jetës. Mendimi im është të kthehen sytë nga Orikumi, qyteti ynë. Të diskutohet me mësuesit, të ketë zhvillim qytetit. Duhet rregulluar infrastruktura. Duhet ndërhyrë këtu, nga specialistët e pushtetit vendor apo qendror.

Z.Ermal Dredha – Në lidhje me zhvillimin e pronës, çdo gjë do kohën e vet.

Z.Arsen Belaj – Rrugët janë copë -- copë,

Z.Ermal Dredha – Ne kur kalojmë buxhetin në këshillin bashkiak...Vlora përditë po zgjerohet. Na sillni propozime konkrete. Pra menaxhimin e ujrave të zeza, fasadat e pallateve.

Z.Gëzim Çapoj – Orikumi sjell të ardhura. Po ti ktheheshim Orikumit, do ishte bërë. Orikumi të kishte projektet gati..Ka pas shumë projekte.

Z.Valter Hasani/ Banor. Sezoni i kaluar dhe ky që po vjen , aeroporti që po bëhet, sjell një problem në lidhje me infrastrukturën. Duhet një studim për pikat e qendrave të autobuzave dhe urbanëve, sepse duhet të lëvizin të huajt. Duhet parë shumë seriozisht në lidhje me këto pika.

Z.Gjergji Nika -- Tek PBA a ka donatorë? Drejtoria e Urbanistikës duhet të bëjë projekte dhe t’jua paraqesë donatorëve.

Z.Ermal Dredha -- Është e llogjikshme, nuk është se ka pasur projekte të gatëshme.

Z.Gjergji Nika – Donatorët marrin nga projektet, ato më të vogla..

Z.Ermal Dredha – S'ka pasur projekte të mbartura, vetëm bëhen thjesht ato për PBA. Do jetë një vendimarrje e Këshillit bashkiak, për shkak të disa ndërhyrjeve. Si model kemi bashki të tjera, si ajo e Beratit , pra të ketë njëfarë buxheti për këto projekte, por ka një farë kontrate me studiot projektuese.

Z.Arsen Belaj – Për inspektorët e tatimeve, të gjitha bizneset që kanë zënë sipërfaqe(spl)..Pse si ndani , të hapur me të mbyllur? Në Orikum, është 2000lekë/vjetra m2.I kanë të hapura jo të mbyllura, jo 4000lekë/vjetra m2.

Z.Mehmet Xhelilaj/Banor - Çuni është në shkollën e mesme “ Industriale “...Nuk ka marrë lekët e transportit. Ku duhet të drejtohem?

Z.Ermal Dredha – Të vini me propozime konkrete.

Faleminderit!

Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik

Albana Naçi